



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.04.2021

Dokument parlamentar

## RAPORT

### PËR

**AKTIN NORMATIV NR. 9, DATË 22.3.2021**

**“PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHENDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR "KEYMEN ILAC SANA YI VE TI CARET", A.S, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (VERO CELL) CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD. DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS”**

- *Hyrje*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*referuar në vijim “Komisioni”*), në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 12.04.2021, mori në shqyrtim aktin normativ nr. 9, datë 22.03.2021 “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "KEYMEN ILAC SANA YI VE TI CARET", A.S, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid - 19 (VERO CELL) CORONAVAC, të krijuar nga SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”.

Akti normativ shqyrtohet nga Komisioni sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit, për të prezantuar aktin normativ dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, ishin të pranishëm zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Mira Rakacolli dhe Sekretarja e Përgjithshme znj. Geraldina Prodani.

- *Baza kushtetuese e aktit normativ*

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën

përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit. Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i këtij akti normativ kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

- *Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ*

Akti normativ ka për qëllim të miratojë tekstin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "KEYMEN ILAC SANA YI VE TI CARET", A.S. për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuara në Republikën Popullore të Kinës.

Në relacionin e Këshillit të Ministrave parashtrihen argumentet lidhur me përparësitë, problematikat dhe efektet e pritshme të kësaj marrëveshjeje, teksti i të cilës propozohet të miratohet nëpërmjet këtij akti normativ. Konkretisht, Shqipëria është furnizuar me vaksina nga kompania Pfizer dhe AstraZeneca të cilat u alokuan nëpërmjet mekanizmit Covax dhe nëpërmjet marrëveshjes së firmosur me Pfizer. Zhvillimet në dinamikë të procesit të vaksinimit në mbarë botën kanë bërë që shumë vende të kenë vëmendje të shtuar edhe ndaj vaksinave të tjera të prodhuara në vende si Republika Popullore e Kinës apo Federata Ruse. Për këtë arsye, si dhe për të shqyrtuar çështjet teknike të lidhura me vaksinimin e popullatës e grupeve të caktuara, është mbledhur Komiteti i Ekspertëve për Imunizimin, i cili është një organ këshillimor i ministrit të Shëndetësisë, parashikuar nga ligji nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar. Komiteti ka marrë në shqyrtim vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19, Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Sciences, Pekin, Kinë. Ky komitet është shprehur se ajo është një vaksinë që përmban virusin e inaktivizuar SARS-Cov-2. Janë dhënë rezultatet e fazës së parë dhe të dytë të kësaj vaccine në Kinë dhe kanë filluar provat e fazës së tretë që në korrik 2020 në Kinë dhe më pas në Brazil, Turqi, Indonezi dhe Kili. Provat e fazës së tretë të kryera në Brazil dhe Turqi vlerësuan efikasitetin e vaksinës të punonjësit shëndetësorë që ofronin trajtim për pacientët me COVID-19 dhe ishin prova të randomizuara, double-blind dhe të kontrolluara me placebo. Kjo tregoi një efikasitet ndaj sëmundjes kryesisht 100% për ato që kërkonin hospitalizim, rastet e rënda dhe fatale sipas të dhënave të publikuara vetëm në faqen zyrtare të kompanisë. Kjo vaksinë është aprovuar për përdorim emergjent në Kinë nga Autoriteti Rregullator në Kinë dhe gjithashtu është aprovuar në disa shtete të tjera si: Azerbaixhan, Bolivi, Brazil, Republikën Dominikane, Ekuador, Hong Kong, Indonezi, Laos, Meksikë, Paraguaj, Filipine, Tailandë, Tunisi, Turqi, Ukrainë dhe Uruguaj etj.

Lidhur me përdorimin në popullatë të këtyre vaksinave është shprehur edhe komiteti i përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri, i ngritur me urdhrin nr.53, datë 31.1.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për ngritjen e Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri". Ky komitet ka vlerësuar dhe propozuar përdorimin e kësaj vaccine në popullatë.

Nisur nga fakti që vaksinat e prodhuara në Kinë dhe Rusi kanë vetëm aprovimin nga trupat çertifikuese të vendeve të tyre për përdorimin në popullatë, u kërkua një vendimmarrje edhe nga Komiteti i Etikës, i cili është një organ i pavarur, i parashikuar nga ligji nr.105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, i përbërë nga profesionistë të shëndetit ose jo, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e të drejtave, sigurisë dhe mirëqënies së personave të përfshirë në provat klinike. Në mbledhjen e datës 9.3.2021, Komiteti, duke vlerësuar se përdorimi i vaksinave anticovid-19 është i domosdoshëm në kushtet e pandemisë që po kalon vendi, vendosi që të lejohet përdorimi i atyre vaksinave të miratuara nga EMA, FDA-ja dhe nga trupa të tjera certifikuese të vendeve që kanë prodhuar vakcina anticovid-19 dhe aplikimi i tyre të shoqërohet me një Inform Consent ku sqarohen efektet pozitive dhe ato anësore.

Ministria e Shëndetësisë Turke, në kuadër të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë, i është përgjigjur interesit të shprehur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë lidhur me procesin e vaksinimit. Ajo ka informuar palën shqiptare se vakcina që po përdoret në popullatën Turke është vakcina që përmban antigenin viral Sars-Cov-2 të inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell), Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. Ministria e Shëndetësisë Turke gjithashtu informoi palën shqiptare mbi procesin e provave klinike si dhe efikasitetin e vaksinës, i cili sipas të dhënave të mbledhura deri më 23 dhjetor 2020 u gjet të ishte në një interval besimi prej 95%. Kjo vaksinë që po përdoret në popullatën turke ka marrë autorizim përdorimi emergjent nga Agjencia Turke e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Vlerësimet shkencore dhe analizat e kryera në laboratorët e analizës dhe kontrollit të Agjencisë Turke të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore rezultuan se vakcina ishte e pranueshme për të dhënë autorizimin e përdorimit urgjent nga Agjencia Turke e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë ka informuar palën shqiptare se deri tani janë vaksinuar me këtë vaksinë në total 10 372 000 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë) persona, nga të cilët të gjithë personat mbi 65 vjeç dhe rreth 1 000 000 (një milion) punonjës shëndetësor. Sipas informacioneve të përcjella nga Ministria e Shëndetësisë Turke, kompania "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. është distributor i autorizuar në disa vende, përfshirë Turqinë dhe Azerbajxhanin dhe është caktuar edhe distributor i autorizuar i kësaj vaccine për Shqipërinë. Në vijimësi të këtij procesi, Këshilli i Ministrave, me aktin normativ nr. 6, date 10.3.2021, ka mundësuar dhënien e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për zhvillimin e negociatave me prodhuesit, me distributorë të autorizuar, me qeveritë ose institucionet e autorizuar prej tyre, të vendeve që prodhojnë ose distribuojnë vakcina anticovid, për të siguruar këto vakcina, të cilat janë të çertifikuara nga trupa çertifikuese në vendin e prodhimit të tyre.

Në datën 10.3.2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë një letër shprehjeje interesi nga kompania turke "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. për të fumizuar Republikën e Shqipërisë me 1 000 000 (një milion) doza vaccine të vaksinës Coronavac, të krijuar nga Sinovac

Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuara në Republikën Popullore të Kinës. Në letrën e shprehjes së interesit kompania ka paraqitur historikun e saj, ku ndër të tjera thekson se 6 nga 10 vaksinat e parashikuara nga Programi i Përgjithshëm i Imunizimit në Turqi janë fumizuar prej saj. Bashkëpunimi me kompaninë Sinovac ka nisur në 2013 dhe Keymen ka bashkëpunuar me Republikën e Turqisë për të kryer testimet e fazës së tretë klinike, ku pas tyre, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë ka nënshkruar një marrëveshje me këtë kompani për blerjen e një numri të konsiderueshëm të dozave të vaksinave.

Në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, kjo është një mundësi e volitshme për Republikën e Shqipërisë, edhe për lehtësi logjistike, pasi është më e lehtë për ta transportuar vaksinën nga Turqia në vendin tonë. Nëpërmjet aktit normativ nr. 7, datë 12.3.2021, të Këshillit të Ministrave që ndryshon aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021 *"Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe fumizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer Export BV, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti-Covid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë"*, vaksinat anticovid-19 aprovohen për përdorim në popullatë bazuar në aprovimet e Food and Drugs Administration të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (FDA), ose European Medicine Agency (EMA) të Bashkimit Evropian ose të trupave të tjera certifikuese të vendeve që prodhojnë vakcina anticovid-19. Në vijim të shprehjes së interesit të kompanisë si më sipër, u ngrit një grup pune multidisiplinor dhe ndërministror për vlerësimin e kushteve të kontratave që do të lidhen me prodhuesit, me distributorë të autorizuar, me qeveritë ose institucionet e autorizuar prej tyre, për të siguruar vakcina anticovid, të cilat janë të certifikuar nga trupa certifikuese në vendin e prodhimit të tyre. Grupi i punës mori në shqyrtim projekt kontratën e propozuar nga kompania turke "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. dhe përgatiti relacionin bashkë me projektin final të kontratës së dakordësuar. Distributori i autorizuar "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. paraqiti autorizimin e marrë nga kompania Sinovac Life Science Co, Ltd., i cili është i vlefshëm nga data 15.2.2021 deri 31.12.2021. Marrëveshja përmban parashikime lidhur me çmimin, dozat, standardin dhe cilësinë e produktit, dërgimin e tij në Shqipëri, sigurimin e produktit, zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj.

Me anë të këtij akti normativ synohet të miratohet teksti i kësaj marrëveshjeje ndërmjet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilar; Sanayi ve Ticaret", A.S. Akti normativ përbëhet nga 3 nene me përmbajtje si më poshtë:

*Neni 1* parashikon miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. për fumizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës. Marrëveshja për

furnizimin, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga "Keymen Ilac Sana yi ve ti caret", A.S. nuk do të publikohet në asnjë website të institucioneve apo në "Fletoren zyrtare". Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit, apo që janë pjesë e procesit, kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ. Ky nen parashikon gjithashtu se detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid janë të njëjta me ato të përcaktuara në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

*Neni 2* parashikon se efektet financiare që rrjedhin nga marrëveshja përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

*Neni 3* parashikon hyrjen në fuqi menjëherë të aktit normativ dhe botimin në "Fletoren zyrtare".

- ***Vlerësimi i kushtetueshmërisë së aktit normativ***

Akti normativ është nxjerrë nga Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 101 të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese parashikon të drejtën e Këshillit të Ministrave që në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj, ku mund të përmendim vendimin nr. 24, datë 10.11.2006, nr. 1, datë 6.2.2013, nr. 5, datë 5.2.2014, ka interpretuar kuptimin e termave "nevojë" dhe "urgjencë" si elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe si elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Nevoja dhe urgjenca, sipas Gjykatës Kushtetuese, *mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmenden fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot. Nga ana tjetër, elementi urgjencë nuk mund të ekzistojë në vetvete pa nevojën, sepse urgjenca tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa nevoja tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Kuptimin e tyre të vërtetë termat nevojë dhe urgjencë e manifestojnë në kuadër të situatës të rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre.*

Ndërhyrja përmes këtij akti normativ shfaqet e nevojshme dhe urgjente, në kushtet kur situata e krijuar nga Sars-Cov-2 vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara.

Gjykata Kushtetuese, në vendimet e saj nr. 23 datë 16.04.2014; nr. 24, datë 10.11.2006; nr. 1, datë 06.02.2013, ka mbajtur qëndrimin se *Kuvendi është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Duke përdorur termin “miraton”, Kushtetuta ka parasysh vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe shprehjen e mendimit përfundimtar nga organi vlerësues lidhur me aktin që shqyrton. Natyra e këtij vlerësimi është politike, por edhe juridike. Gjykata ka vlerësuar se kontrolli që ushtron Kuvendi ndaj aktit normativ është edhe i karakterit substancial. Përpara miratimit ose mosmiratimit të normës së nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi e shqyrton atë për ta vlerësuar si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Ai shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi.*

Akti normativ nr. 9, datë 22.3.2021 është publikuar në Fletoren zyrtare nr. 45, datë 23 Mars 2021 dhe i është dërguar për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili është brenda afatit Kushtetues (brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e tij) për ta shqyrtuar atë.

- ***Diskutime në komision***

Prezantimi i aktit normativ u bë nga zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Mira Rakacolli, e cila e nisi prezantimin e saj duke sjellë në vëmendje numrin e madh të njerëzve që kanë humbur jetën dhe sfidën e madhe me të cilën po përballen sistemet shëndetësore në mbarë botën për të luftuar pandeminë e shkaktuar nga Covid-19. Jemi në kushtet, u shpreh ajo, të një mjekimi jo specifik për të luftuar këtë sëmundje infektive dhe e vetmja zgjidhje për të shpëtuar jetët e njerëzve mbetet vaksinimi masiv, krahas masave që rekomandohen për parandalimin e infektimit. Asnjëherë kërkimet shkencore dhe industria e prodhimit të vaksinave, tha ajo, nuk kanë njohur një intensitet kaq të madh dhe si rezultat i këtyre përpjekjeve sot janë në studim mbi 200 vaksina, disa prej të cilave fatmirësisht i kanë kaluar të gjitha provat. Por tashmë sfida e të gjitha qeverive të çdo vendi të botës mbetet sigurimi i sasisë së vaksinave dhe organizimi i kryerjes korrekt të të gjithë procesit të vaksinimit. Sigurimi i vaksinës për qeverinë shqiptare ka qenë dhe mbetet prioritet për përballimin e pandemisë e cila ka ndjekur me vëmendje dhe kujdes zhvillimet kudo në botë dhe ka arritur të sigurojë vaksina nga kompania Pfiser, AstraZeneca, vaksina të cilat janë të miratuara nga FDA-ja dhe nga EMA. Në kushtet e emergjencës, kur Shqipëria si shumë vende të tjera të botës i ka hapur rrugën edhe vlerësimit për përdorim të vaksinave të certifikuara nga trupat certifikuese të vendeve prodhuese, janë bërë përpjekje edhe për to. Znj. Rakacolli theksoi se Shqipëria është vendi i parë në rajon në ritëm vaksinimi, në numër vaksinash për 100 persona. Një nga vaksinat e përdorura dhe të vlerësuara, sipas saj, është vaksina Coronavac e prodhuar nga kompania kineze Sinovac. Kjo vaksinë ka autorizimin e trupës certifikuese të Kinës dhe të 22 vendeve të tjera, ku po vazhdon me sukses prej kohësh përdorimi i saj. Vaksina Sinovac është vlerësuar nga Komiteti i Ekspertëve të Imunizimit, i përbërë nga ekspertët më të mirë teknikë të vendit në fushën e vaksinimeve dhe që vlerëson çdo lloj vaksine që hyn në Shqipëri. Ky komitet ka analizuar me vëmendje dhe kujdes të gjitha rezultatet dhe fazat e studimit të kësaj vaksine, ndër të cilat rezultati më mbresëlënës është ai i sigurisë 100% për sa i përket shpëtimit të jetës dhe nevojës për t’u trajtuar në njësitë e kujdesit intensiv. Për këtë arsye, u shpreh ajo, ky komitet e ka klasifikuar si një nga vaksinat që mund të përdoret me sukses në Shqipëri. Të njëjtin konkluzion

ka arritur edhe Komiteti i Ekspertëve për Menaxhimin e Pandemisë Covid 19, po ashtu edhe Komiteti i Etikës, si një trupë e pavarur në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me përdorimin e barnave, të pajisjeve mjekësore, apo të vaksinave. Pas marrjes së informacioneve edhe nga Ministria e Shëndetësisë së Turqisë, në vijim të këtij interesi, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur grupi ndërministror dhe multidisiplinor për vlerësimin e kushteve të kontratave që do të lidhen me prodhuesit apo me distributorët e autorizuar të tyre për vaksinat antikovid. Teksti i kësaj kontrate është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe pas këtij miratimi është nënshkruar edhe marrëveshja me këtë kompani. Në përmbyllje të prezantimit të saj, znj. Rakacolli theksoi se miratimi nga Kuvendi i kësaj marrëveshjeje bën të mundur vaksinimin e shumë qytetarëve, e si rezultat shpëtimin e jetës së njerëzve, përmirësim në shëndetin mendor të tyre dhe përmirësim të ndjeshëm në ekonominë e turizmin e vendit.

Relatorja, znj. Vasilika Hysi, theksoi rëndësinë që paraqet miratimi i aktit normativ në kushtet e situatës së vështirë që po kalon e gjithë bota dhe përpjekjeve të çdo qeverie për të adresuar në kohë vaksinimin masiv të popullsisë. Në vijim të fjalës së saj, znj. Hysi analizoi përputhshmërinë e aktit normativ me elementët kushtetues përcaktues për nxjerrjen e aktit normativ nga Këshilli i Ministrave. Jemi në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, u shreh ajo, pasi e gjithë bota po kalon një periudhë të vështirë. Me të gjitha përpjekjet që po bëhen, ende vaksinimi i popullsisë në botë dhe në Shqipëri është larg asaj që duhet për të arritur imunitetin e pjesës së madhe të shoqërisë. Për rrjedhojë, vlerësoi ajo, është e rëndësishme dhe e domosdoshme miratimi i një marrëveshjeje që i mundëson Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik të sigurojnë numrin e nevojshëm të vaksinave. Urgjenca për nxjerrjen e këtij akti normativ lidhet me procedurën e gjatë parlamentare e cila nuk do të mundësonte sigurimin në kohë të sasisë së nevojshme të vaksinave për të vijuar me zhvillimin e vaksinimit sipas procedurave dhe dozave përkatëse. Duke vlerësuar përputhshmërinë kushtetuese dhe rëndësinë që paraqet akti normativ, znj. Hysi ftoi anëtarët e komisionit ta votojnë atë.

- ***Përfundime***

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke vlerësuar se akti normativ nr. 9, datë 22.03.2021 "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "KEYMEN ILAC SANA YI VE TI CARET", A.S, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid - 19 (VERO CELL) CORONAVAC, të krijuar nga SINOVAC LIFE SCIENCE CO, LTD. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës", është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi atë dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

**RELATORE**

**VASILIKA HYSI**

**KRYETAR**

**ULSI MANJA**

